



## MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – Zgjedhjet lokale, 24 mars 2013

---

### DEKLARATA PËR KONSTATIMET DHE PËRFUNDIMET PRELIMINARE

**Shkup, 25 mars 2013** – Kjo deklaratë për konstatimet dhe përfundimet preliminare është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (OSBE/ODIHR) dhe të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi).

Ambasadori Geert-Hirnrich Ahrens është Shefi i Misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ), që ka filluar me punë më 25 shkurt 2013. Z. Juri Landberg është udhëheqës i delegacionit të Kongresit.

Është bërë vlerësimi për përcaktimin e përputhshmërisë së zgjedhjeve me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës, si dhe me legjislacionin e vendit. Kjo deklaratë për konstatimet dhe përfundimet preliminare jepet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet pjesërisht nga realizimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, në veçanti nga mbledhja e rezultateve dhe nga trajtimi i parashtrësive dhe ankesave të mundshme nga dita e ardhshme e zgjedhjeve. OSBE/ODIHR do të përgatisë një raport përfundimtar gjithpërfshirës, përfshirë edhe rekomandimet për përmirësimet e mundshme, për rreth tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor. Raporti i Kongresit do të miratohet në mbledhjen plenare në tetor të vitit 2013.

### PËRFUNDIMET PRELIMINARE

Zgjedhjet lokale të 24 marsit u administruan në mënyrë efikase dhe me konkurrencë të lartë. Edhe pse fushata ishte aktive, mbulimi partiak mediatik dhe mosndarja e qartë e aktiviteteve shtetërore dhe atyre partiake, jo gjithmonë ofruan mundësi të barabarta për garimin e kandidatëve në zgjedhje. Tensionet ndëretnike e lanë nën hije fushatën. Dita e zgjedhjeve ishte e qetë, edhe pse u vërejtën disa parregullsi procedurale.

Zgjedhjet u mbajtën në vijim të bojkotimit të parlamentit dhe shpalljes për bojkotimin e zgjedhjeve nga ana e Lidhjes Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM), që përfundoi më 1 mars, në bazë të marrëveshjes së ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, ndërmjet udhëheqësve të LSDM-së dhe të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE).

Korniza ligjore zgjedhore është gjithpërfshirëse. Përveç amandamenteve të nëntorit të vitit 2012, Kodi Zgjedhor është ndryshuar në mënyrë plotësuëse disa javë para zgjedhjeve për ta vazhduar afatin për paraqitjen e kandidatëve. Ndonëse nuk është praktikë e mirë që korniza ligjore të ndryshohet më pak se një vit para zgjedhjeve, ndryshimi i fundit u bë me konsensus gjithëpartiak. Nevojitet reformë e mëtejshme për t'i trajtuar zbrazëtitrat në Kodin Zgjedhor.

Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) funksionoi në mënyrë efektive dhe transparente duke iu përmbajtur afateve të caktuara zgjedhore. Megjithatë, KSHZ-ja votoi përgjatë vijave etnike për ta lejuar tërheqjen e listave të kandidatëve, që ndikoi negativisht në paanshmërinë dhe kolegialitetin e tij. Përderisa mbledhjet e KSHZ-së ishin të hapura për mbikëqyrësit e zgjedhjeve dhe mediat, disa komisione zgjedhore komunale nuk njoftuan paraprakisht për mbledhjet e tyre dhe morën vendime në grupe joformale të punës, duke e zvogëluar kështu transparencën e punës së tyre.

Në përgjithësi, procesi i paraqitjes së kandidatëve ishte përfshirës dhe iu ofroi votuesve zgjedhje të ndryshme. Megjithatë, vendimi për ta vazhduar afatin për paraqitjen e kandidatëve nuk vlente për grupet e votuesve. Kjo është në kundërshtim me parimet që janë paraparë në paragrafet 7.5 dhe 7.6 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990, të cilat kërkojnë nga autoritetet ta respektojnë të drejtën e të gjithë kandidatëve për të garuar për funksione publike, pa diskriminim.

Në përputhje me kërkesat ligjore, një në çdo tre vende në listat e kandidatëve për këshilltarë, në përgjithësi, ishin të rezervuara për gjininë më pak të përfaqësuar. Edhe pse më parë nuk kishte asnjë kryetare komune, 32 femra u paraqitën si kandidatë për kryetare komune në këto zgjedhje dhe 2 u zgjedhën në rrethin e parë dhe 1 do të garojë në rrethin e dytë. Kriteri për përfaqësimin gjinor u respektua në organet për administrimin e zgjedhjeve.

Kandidatët kishin mundësi ta zhvillojnë fushatën e tyre në mënyrë të lirë dhe qasja në hapësirat publike u mundësua pa pengesë. Fushata ishte aktive. Kandidatët, kryesisht ju drejtoheshin votuesve nga bashkësia e tyre etnike. Akuzat për frikësim të votuesve dhe keqpërdorim të burimeve shtetërore ishin të pranishme gjatë gjithë fushatës. MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vërejtur disa raste të materialeve propaganduese të fushatës të vendosura në pronë shtetërore, si dhe raste të zyrtarëve qeveritarë që kanë ndjekur tubime të fushatës në orar të punës, duke i përdorur veturat qeveritare. Mosndarja e qartë ndërmjet aktiviteteve shtetërore dhe atyre partiake nuk është në përputhje me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Rreth 119,000 qytetarë u mënjanuan nga lista zgjedhore e votuesve para këtyre zgjedhjeve, për shkak se nuk kishin letërnjoftim ose pasaportë biometrike. Pastrimi i listës zgjedhore të votuesve e gëzoi përkrahjen e të gjitha partive kryesore. Përkundër besimit të shtuar në saktësinë e listës zgjedhore të votuesve, disa ankesa vazhduan të parashtrihen, duke përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve. Është e dobishme të përmirësohen procedurat për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e listave.

Numri i ankesave të parashtruara në gjyqe ishte minimal dhe shumë palë i thanë MVZ të OSBE/ODIHR-it se nuk kanë besim në procedurat për ankim dhe në gjyqet. KSHZ-ja nuk ndërmori asnjë veprim për mbi 400 ankesa që kishin të bëjnë me aktivitetet parazgjedhore para fillimit zyrtar, që u dorëzuan para ditës së zgjedhjeve. Mungesa e procedurave të qarta për trajtimin e ankesave parazgjedhore nga KSHZ-ja nuk garanton ndreqje efektive, siqë parashihet në paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Ndërkohë që mediet e mbikëqyrura nga MVZ i OSBE/ODIHR-it siguruan mbulim të gjerë të fushatës në lajmet e tyre, mediet elektronike publike dhe disa media elektronike private e favorizonin koalicionin qeveritar. Mediat elektronike, kryesisht dështuan ta bëjnë dallim ndërmjet aktiviteteve shtetërore dhe fushatës zgjedhore të partive. Ndërkohë që transmetuesi publik ndau kohë për emitim pa pagesë për kandidatët dhe krijoi një program të veçantë për t'i mbuluar aktivitetet e fushatës zgjedhore, ato u emituan jashtë kohës me shikueshmëri të lartë, duke e kufizuar kështu shikueshmërinë e tyre potenciale.

Procesi i votimit ishte i qetë dhe paqësor, ndonëse në disa vendvotime të vizituara nuk u ndoqën procedurat e parapara. Vazhduan rastet e votimit grupor si dhe fshehtësia e votës nuk u respektua gjithmonë. Shumica e rasteve të vëzhguara të numërimit të votave u vlerësua pozitivisht, edhe pse nganjëherë u vërejtën lëshime procedurale. Mbledhja e rezultateve u vlerësua pozitivisht në të gjitha KZK-të e vëzhguara, përveç në pesë prej tyre. KSHZ-ja njoftoi se përqindja preliminare e daljes në votime ishte 67%.

## KONSTATIMET PRELIMINARE

### Konteksti

Pas përjashtimit të dhunshëm të deputetëve opozitarë dhe të mediave nga Kuvendi gjatë votimit për buxhetin vjetor të shtetit më 24 dhjetor 2012, Partia Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) dhe disa nga partnerët e saj të koalicionit filluan ta bojkotojnë punën e Kuvendit. Më 2 janar 2013, LSDM-ja njoftoi se do t'i bojkotojë edhe zgjedhjet lokale përderisa nuk plotësohen disa kërkesa<sup>1</sup>. Partia në pushtet, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe LSDM-ja nuk ishin në gjendje të gjejnë kompromis për t'i dhënë fund krizës politike. Bojkotimi i Kuvendit dhe i zgjedhjeve lokale përfundoi më 1 mars, vetëm pasi që Bashkimi Evropian ndërmyetësoi një marrëveshje ndërmjet udhëheqësve të këtyre dy partive<sup>2</sup>.

Tre partitë më të mëdha etnike shqiptare të përfaqësuara në Kuvend, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) dhe Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK), nuk iu bashkangjiten bojkotimit dhe që nga fillimi e shprehën qëllimin e tyre për të marrë pjesë në zgjedhje.

Si rezultat i krizës politike, këto zgjedhje fituan një rëndësi edhe më të madhe politike, jashtë suazave lokale. Lideri i kolacionit të VMRO-DPMNE-së këto zgjedhje i përshkroi si referendum për ardhmërinë e vendit, ndërsa kryetari i LSDM-së theksoi që rezultatet e zgjedhjeve do të përcaktojnë nëse duhet të mbahen zgjedhje të

---

<sup>1</sup> Këtu është përfshirë organizimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, reforma e Kodit Zgjedhor, revizioni i detajuar i listës zgjedhore të votuesve, dorëheqja e Ministrit për Financa, për Punë të Brendshme, për Drejtësi dhe Drejtorit të përgjithshëm të Radio Televizionit të Maqedonisë (RTM).

<sup>2</sup> Teksti i marrëveshjes mund të gjendet në: [http://ec.europa.eu/commission\\_2010-2014/fule/headlines/news/2013/03/20130301\\_en.htm](http://ec.europa.eu/commission_2010-2014/fule/headlines/news/2013/03/20130301_en.htm).

parakohshme parlamentare ose jo. Poashtu, këto zgjedhje në masë të gjerë u konsideruan si një test i rëndësishëm në kontekst të ambicies së përbashkët të të gjitha partive kryesore politike për ta promovuar integrimin euroatlantik të vendit.

Zgjedhjet e vitit 2013 ishin të parat pas bashkimit të pesë komunave në komunën e vetme të Kërçovës. Zvogëlimi i komunave dhe ndryshimi i profilit demografik të Kërçovës, krijoi një konkurrencë të shtuar ndëretnike në garën për kryetar të kësaj komune dhe këshillin e komunës.

### **Korniza ligjore dhe sistemi zgjedhor**

Korniza ligjore për zgjedhjet lokale kryesisht përcaktohet me Kushtetutën dhe Kodin zgjedhor. Përveç amandamenteve të nëntorit të vitit 2012, Kodi Zgjedhor u ndryshua në mënyrë plotësuese disa javë para zgjedhjeve, për ta vazhduar afatin për paraqitjen e kandidatëve<sup>3</sup>. Edhe pse nuk është praktikë e mirë që korniza ligjore të ndryshohet më pak se një vit para zgjedhjeve, ndryshimi i fundit u bë me konsensus gjithpartiak<sup>4</sup>. Afatet e tjera kohore në Kodin Zgjedhor, përfshirë edhe datën e fillimit të fushatës zgjedhore, nuk u ndryshuan për ta pasqyruar vazhdimin e mësipërm, që krijoi huti se kur kandidatët mund ta fillojnë fushatën e tyre në mënyrë ligjore.

Ndonëse kohëve të fundit ka pasur disa reforma të Kodit Zgjedhor që ishin rezultat i rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës, duhet të trajtohen zbrazëtitrat dhe paqartësitë e mbetura, duke i përfshirë dispozitat për financimin e fushatës, paraqitjen e kandidatëve, si dhe kundërshtimet dhe ankesat. Misioni Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ) e përshëndetë marrëveshjen e dy partive kryesore politike për të vazhduar me procesin e reformave zgjedhore pas përfundimit të këtyre zgjedhjeve.

Zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe këshillat komunale mbahen çdo katër vjet, në gjysmën e dytë të muajit mars. Secila prej 80 komunave dhe Qyteti i Shkupit zgjedhin kryetar komune dhe këshill komunal. Kryetarët e komunave zgjidhen sipas modelit të shumicës që përbëhet nga dy rrethe. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk fiton më shumë se 50% të votave në rrethin e parë, mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve brenda dy javëve, ndërmjet dy kandidatëve që kanë fituar numër më të madh të votave. Për të qenë zgjedhjet valide në rrethin e parë, duhet të kenë dalë në votime së paku një e treta e votuesve të regjistruar në listën zgjedhore.

Këshilltarët komunalë zgjidhen sipas modelit të përfaqësimit proporcional me lista të mbyllura dhe pa kusht për përqindjen e votuesve që kanë dalë në zgjedhje. Numri i këshilltarëve që zgjidhen për çdo komunë varet nga numri i banorëve të komunës. Numri i këshilltarëve nuk mund të jetë më i ulët se 9 e as më i lartë se 33, përveç në Qytetin e Shkupit, ku numri i këshilltarëve është 45.

---

<sup>3</sup> Amandamentet e nëntorit të vitit 2012 u miratuan me shumicë të ngushtë në Kuvend (66 nga 123 deputetë) ku partitë opozitare abstenuan nga votimi.

<sup>4</sup> Kodi për praktika të mira në çështjet zgjedhore i Komisionit të Venedikut rekomandon se “nuk duhet të lihet hapësirë që elementet fundamentale të ligjit zgjedhor... të ndryshohen më së paku një vjet para zgjedhjeve”. <http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD%282002%29023rev-e.aspx>

## Administrimi i zgjedhjeve

Zgjedhjet lokale janë administruar nga administrata zgjedhore e organizuar në tre nivele, që përbëhet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), 80 komisione zgjedhore komunale (KZK) dhe Komisioni Zgjedhor për Qytetin e Shkupit, si dhe 2,976 këshilla zgjedhorë (KZ). Kryetari i KSHZ-së dhe dy anëtarë të tij emërohen nga partitë opozitare parlamentare, ndërsa nënkryetari dhe tre anëtarë emërohen nga partitë në pushtet. KZK-të janë organe profesionale me pesë anëtarë, të zgjedhura në mënyrë të rastësishme nga radhët e të punësuarve në administratën publike. KZ-të ishin të përbëra nga një model i përzier profesional-politik, me një anëtar të emëruar nga partitë politike në pushtet, një nga partitë opozitare dhe tre anëtarë të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga të punësuarit në administratën publike. Ashtu si që parashih Kodi Zgjedhor, është respektuar përbërja etnike dhe gjinore e KZK-ve dhe KZ-ve<sup>5</sup>.

Në përgjithësi, KSHZ-ja funksionoi në mënyrë efikase dhe transparente, duke iu përmbajtur të gjitha afateve kohore zgjedhore. Mbledhjet e KSHZ-së ishin të hapura për mbikëqyrësit e zgjedhjeve dhe për mediat dhe vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve u publikuan në ueb-faqen e KZSH-së, në përputhje me rekomandimet e mëhershme të OSBE/ODIHR-it. Mirëpo, më 8 mars, KSHZ-ja votoi e ndarë në baza etnike, për ta mundur tërheqjen e listave të kandidatëve në komunat e përziera etnike të Kërçovës dhe të Strugës, që ndikoi negativisht në paanshmërinë dhe kolegialitetin e KSHZ-së.

Disa KZK nuk i paralajmëruan takimet e tyre paraprakisht dhe vendimet shpesh herë u morën në grupe pune që nuk ishin publike, duke e dëmtuar transparancën e tyre. Shumica e KZK-ve u ballafaquan me probleme financiare për shkak se nuk arritën që t'i marrin mjetet e nevojshme financiare me kohë dhe në disa raste anëtarët e KZK-ve i shfrytëzuan mjetet e tyre personale<sup>6</sup>. KZK-të organizuan trajnime për KZ-të, në përputhje me obligimin e tyre ligjor. Aktivitetet për edukimin e votuesve nga ana e KSHZ-së ishin të kufizuara.

## Regjistrimi i votuesve

KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen e listave zgjedhore të votuesve duke u bazuar në informatat e nxjerra regjistri i përhershëm civil, që mbahet nga Ministria për Punë të Brendshme. Mund të regjistrohen dhe të votojnë të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet ose kanë më tepër se 18 vjet në ditën e zgjedhjeve, që kanë

---

<sup>5</sup> Sipas nenit 21 të Kodit Zgjedhor, bashkësitë etnike që përbëjnë më shumë se 20 përqind të popullatës së një komune duhe të jenë të përfaqësuara në KZK-të dhe KZ-të, ndërsa së paku 30 përqind e anëtarëve në të gjitha komisionet zgjedhore duhet të jenë nga secila gjini

<sup>6</sup> KSHZ-ja e informoi MVZ-në të OSBE/ODIHR-it se, që nga shtatori i vitit 2012, ata i kanë dërguar mbi 20 letra qeverisë, parlamentit dhe kryetarëve të komunave, për të kërkuar ndihmë financiare për 25 komuna. KZK-të e Dellçevës, Demir Hisarit, Dollnenit, Gostivarit, Likovës, Rakonvcës, Studeniçanit, Shuto Orizarës dhe Vrapçishtit e informuan MVZ-në të OSBE/ODIHR-it se ato nuk kanë marrë para nga komunat.

vendqëndrim në komunën e tyre, që kanë letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme biometrike dhe të cilëve nuk ju është mohuar e drejta e tyre ligjore me vendim gjyqësor.

Rreth 119,000 qytetarë janë mënjanuar nga listat zgjedhore të votuesve për shkak se nuk kanë pasur letërnjoftime ose pasaporta biometrike. Pastrimi i listës zgjedhore të votuesve e gëzoi përkrahjen e të gjitha partive kryesore. Përkundër besimit të shtuar në saktësinë e listës zgjedhore të votuesve, disa ankesa vazhduan të parashtrihen, duke përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve, Është e dobishme të përmirësohen procedurat për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e listave.

Qytetarët kishin mundësi t'i kontrollojnë të dhënat e tyre zgjedhore prej 26 janarit deri më 9 shkurt në zyrat rajonale të KSHZ-së ose nëpërmjet një programi në internet. Garuesit në zgjedhjet lokale kishin mundësi të kërkojnë kopje të listës zgjedhore të votuesve nga KSHZ-ja, në letër ose në formë elektronike. Gjithsej në këto zgjedhje janë regjistruar 1,743,403 qytetarë me të drejtë vote.

### **Paraqitja e kandidatëve**

Kandidatët duhet të jenë qytetarë që kanë të drejtë vote dhe duhet të jenë banorë të komunës ku do të garojnë në zgjedhje. Në zgjedhjet lokale mund të garojnë kandidatët e emëruar nga partitë e regjistruara politike ose koalicionet e partive politike, ose kandidatët e pavarur të emëruar nga grupet e votuesve. Deri në përfundim të afatit të vazhduar më 8 mars janë dorëzuar gjithsej 350 lista për kryetarë komunash dhe 480 lista për këshilla komunalë nga 16 parti politike, 8 koalicione dhe 97 grupe qytetarësh<sup>7</sup>. Në përputhje me kërkesat ligjore, një në çdo tre vende në listat e kandidatëve për këshilltarë, në përgjithësi, është rezervuar për gjininë më pak të përfaqësuar. Edhe pse më parë nuk kishte asnjë kryetare komune, 32 femra janë paraqitur si kandidate për kryetare komune në këto zgjedhje dhe 2 prej tyre u zgjodhën në rrethin e parë, ndërsa 1 do të garojë në rrethin e dytë.

Në përgjithësi, paraqitja e kandidatëve ishte përfshirëse dhe i ofroi votuesve zgjedhje të ndryshme. Mirëpo, vendimi për ta vazhduar afatin për paraqitjen e kandidatëve nuk vlente për grupet e votuesve<sup>8</sup>. Kjo është në kundërshtim me parimet që janë paraparë në paragrafet 7.5 dhe 7.6 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990, ku kërkohet nga autoritetet që ta respektojnë të drejtën e të gjithë kandidatëve për të garuar për funksione publike, pa diskriminim<sup>9</sup>.

---

<sup>7</sup> Disa partive politike, të cilave më parë nuk iu lejua paraqitja për shkak të dorëzimit të vonuar, iu lejua paraqitja e listave në bazë të afateve të reja kohore.

<sup>8</sup> MVZ i OSBE/ODIHR-it ka njohuri për së paku një rast në komunën e Çuçer Sandevës, ku një grup votuesish, lista e të cilëve fillimisht ishte refuzuar për shkak të dorëzimit me vonesë dhe përsëri është refuzuar të regjistrohet sipas afatit të ri kohor.

<sup>9</sup> Paragrafi 7.5 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990, parasheh se shtetet anëtare "e respektojnë të drejtën e qytetarëve për t'u zgjedhur në funksion politik ose publik, individualisht ose si përfaqësues të partive politike ose organizatave, pa diskriminim". Paragrafi 7.6 më tutje parasheh se vendet anëtare duhet "ta respektojnë të drejtën e individëve ose grupeve që të formojnë, në liri të plotë, parti të tyre politike ose organizata të tjera politike, dhe partive të këtylla politike dhe organizatave

Përkundër raporteve zakonisht kundërshtuese, VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja u morën vesh të dorëzojnë lista të përbashkëta të kandidatëve në Kërçovë dhe në Strugë, ku priteshin gara të ngushta ndërmjet kandidatëve maqedonas dhe atyre shqiptarë. Marrëveshja për të dorëzuar listë të përbashkët u bë pasi VMRO-DPMNE-ja tashmë i kishte dorëzuar listat e kandidatëve, që rezultoi me kërkesën e partisë për t'ia mundësuar asaj tërheqjen e listave në këto dy komuna. Vendimi i KSHZ-së për ta lejuar tërheqjen e listave nuk u pranua nga dy KZK-të dhe ato më pas i refuzuan listat e dorëzuara nga LSDM-ja, për shkak se ato përmbanin kandidatë që tashmë ishin në listën e verifikuar të VMRO-DPMNE-së<sup>10</sup>. LSDM-ja u ankua në Gjykatën Administrative për refuzimin e listës së saj dhe Gjykata i anuloi vendimet e dy KZK-ve më 9 mars. BDI dhe PDSH e vendosën në pikëpyetje ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, duke thënë se KSHZ-ja nuk kishte kompetencë ta miratojë tërheqjen e listave. Në Kërçovë, PDSH-ja publikisht e përkrahu listën e kandidatëve të BDI-së<sup>11</sup>.

## Fushata

Fushata zgjedhore zyrtarisht filloi më 4 mars dhe përfundoi më 22 mars në mesnatë. MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vërejtur disa aktivitete të fushatës para fillimit zyrtar. Poashtu, për shkak të vazhdimit të afatit për dorëzimin e kandidaturave, partitë e koalicionit të udhëhequr nga LSDM-ja e filluan fushatën para se kandidatët dhe listat e tyre të verifikohen nga KZK-të.

Kandidatët kishin mundësi ta zhvillojnë fushatën e tyre në mënyrë të lirë dhe qasja në hapësirat publike u mundësua pa pengesë. Fushata ishte aktive dhe u intensifikua dukshëm gjatë dy javëve të fundit para ditës së zgjedhjeve. Billbordet, posterët dhe afishet dominonin në qytete dhe përgjatë rrugëve kryesore, ku VMRO-DPMNE-ja kishte dukshmëri më të madhe. Për të arritur deri te votuesit, kandidatët e shfrytëzuan edhe fushatën derë-më-derë, pastaj tubimet dhe takimet zgjedhore, si dhe mediat sociale dhe ueb-faqet<sup>12</sup>. Në përgjithësi, kandidatët i kishin në shënjestër votuesit e bashkësive të tyre etnike.

Kriza e paradokohshme politike e acaroi tonin e fushatës zgjedhore dhe përdorimi i retorikës ndarëse në baza etnike rezultoi me ngritjen e tensioneve në kontekstin brenda entiteve dhe ndërmjet tyre<sup>13</sup>. Ndonëse ngjarjet e fushatës zgjedhore në

---

duhet t'ua ofrojnë garancat e nevojshme ligjore që t'u mundësojnë atyre të garojnë me njëri tjetrin, duke pasur trajtim të barabartë para ligjit dhe nga autoritetet”.

<sup>10</sup> Neni 57(2) i Kodit Zgjedhor nuk lejon që një kandidat të paraqitet në dy lista të ndryshme. MVZ i OSBE/ODIHR-it u informua se listat e LSDM-së në Strugë dhe në Kërçovë kishin 12 dhe 13 kandidatë respektivisht, të cilët ishin në listën paraprake të VMRO-DPMNE-së.

<sup>11</sup> Më 4 mars, KSHZ-ja tha se nuk ka procedura ligjore që KSHZ-ja të mund t'i ndryshojë listat e kandidatëve. Procesverbalet nga mbledhjet e KSHZ-së gjenden në: [http://www.sec.mk/index.php?option=com\\_content&view=category&layout=blog&id=42&Itemid=103](http://www.sec.mk/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=42&Itemid=103)

<sup>12</sup> MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vëzhguar 54 tubime

<sup>13</sup> Për shembull, më 13 mars në Strugë, Kryeministri mbajti fjalim gjatë tubimit, me ç'rast tërhoqi vërejtjen për përpjekjet për mobilizimin e votuesve “të palës tjetër” dhe i ftoi maqedonasit etnikë t'i tejkalojnë ndarjet partiake “për shkak se Struga ka një problem që duhet të zgjidhet”. Në Kërçovë,

përgjithësi ishin paqësore, anëmbanë vendit janë shënuar disa raste të shkatërrimit të shtabeve zgjedhore, sulmeve fizike, prishjes ose heqjes së materialeve të fushatës zgjedhore<sup>14</sup>. Protestat e dhunshme që pasuan pas emërimit të Talat Xhaferit për ministër të ri të Mbrojtjes në fillim të fushatës zgjedhore, rezultuan me atë që disa parti politike e akuzonin njëra tjetrën për nxitjen e tensioneve etnike, duke e shtyer bashkësinë ndërkombëtare dhe grupet vendore të shoqërisë civile të apelojnë për qetësi në prag të zgjedhjeve. Në përpjekje për të promovuar një atmosferë pozitive të fushatës, kandidatët në Shkup dhe në disa qytete të tjera, e nënshkruan Kodin e Sjelljes në përkrahje të fushatës paqësore dhe korrekte.

Akuzat për frikësimin e votuesve dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore ishin të pranishme gjatë gjithë fushatës. MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vërejtur disa raste të materialeve propaganduese të fushatës të vendosura në pronë shtetërore, përfshirë edhe vendosjen e tyre në shtyllat e ndriçimit, ndërtesat publike dhe urat, që është në kundërshtim me Nenin 82 të Kodit Zgjedhor. MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vërejtur edhe disa raste të zyrtarëve qeveritarë që kanë ndjekur tubime të fushatës në orar të punës duke i përdorur veturat qeveritare, madje edhe atëherë kur nuk ka pasur brengosje për çështjet e sigurisë. Më tej, qeveria njoftoi se i ka rritur pensionet, ndihmat sociale dhe subvencionet për prodhimet bujqësore gjatë fushatës. Një numër i bashkëbiseduesve të MNVZ-së akuzuan për frikësim të votuesve, veçanërisht të të punësuarve në sektorin publik. Të gjitha këto e mjegulluan vijën ndarëse ndërmjet aktiviteteve shtetërore dhe atyre partiake dhe kjo nuk është në përputhje me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990<sup>15</sup>.

### **Financimi i fushatës**

Të gjithë garuesit në zgjedhje ishin të obliguar të hapin xhiro-llogari të veçantë bankare për donacionet e fushatës dhe të dorëzojnë raporte për shpenzimet e fushatës deri te KSHZ-ja, Enti Shtetëror për Revizion dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Në përputhje me rekomandimin e mëparshëm të OSBE/ODIHR-it, Ministria e Financave përpiloi një formular të detajuar për financimin e fushatës, dhe i trajnoi partitë politike për plotësimin e raporteve. Raportet e para është dashur të dorëzohen më 14 mars, mirëpo afati është prolonguar për 19 mars, për ata që janë paraqitur gjatë afatit të vazhduar për paraqitje<sup>16</sup>. Sipas KSHZ-së, 83 nga gjithsej 121 raporte janë dorëzuar brenda afatit<sup>17</sup>. Këto raporte tregojnë se VMRO-DPMNE-ja ka pasur një avantazh të konsiderueshëm financiar,

---

kandidati i BDI-së Fatmir Dehari, në profilin e tij në një medium social, postoi një fotografi të tijen me veshje ushtarake dhe duke mbajtur një armë automatike.

<sup>14</sup> Duke i përfshirë shtabet e kandidatit për kryetar të komunës së Karposhit, Stevçe Jakimovski, si dhe shtabet e BDI-së në Kërçovë dhe të LSDM-së në Ohër. Poashtu, më 20 mars u sulmua edhe Ajdovan Mamudovi, shefi i shtabit zgjedhor të kandidatit Nezhdet Mustafa (Forcat e Bashkuara Demokratike të Romëve) dhe ky rast është nën hetime.

<sup>15</sup> Paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh “ndarje të qartë ndërmjet shtetit dhe partive politike, në veçanti se partitë politike nuk do të bashkohen me shtetin”.

<sup>16</sup> Vendimi i KSHZ-së bazohet në nenin 15.3 të Kodit Zgjedhor, ku thuhet se afatet kohore zgjedhore përcaktohen nga KSHZ-ja. Mirëpo, ky nen ka të bëjë vetëm me zgjedhjet parlamentare.

<sup>17</sup> Jo të gjitha institucionet i publikuan raportet, ashtu siç është e paraparë me ligj.



duke shpenzuar mbi tre herë më tepër se konkurruesi i saj më i afërt<sup>18</sup>. Raportet e dyta financiare është dashur të dorëzohen deri më 23 mars, ndërsa raportet përfundimtare, 30 ditë pas përfundimit të fushatës. Në ligj nuk janë paraparë afate sa i përket dorëzimit të raporteve financiare të fushatës, nëse ka rreth të dytë të zgjedhjeve.

Ndonëse shpenzimet e fushatës kufizohen në 180 denarë (3 euro) për çdo votues të regjistruar në komunën për të cilën është dorëzuar lista, organizuesit e fushatës janë të obliguar të dorëzojnë një raport të përbashkët për të gjitha listat e tyre, pa i ndarë shpenzimet sipas komunave. Në këtë mënyrë, nuk mund të përcaktohet nëse është respektuar kufizimi i caktuar për shpenzimet. Më tej, mbeten shqetësimet sa i përket dallimit të kufizimeve të ndryshme për donacionet nga individët dhe personat juridikë.

## Mediat

Ka një numër të madh të mediave të regjistruara në vend. Ato ndahen në bazë gjuhësore dhe politike. Televizioni është burimi kryesor i informimit politik. Që nga zgjedhjet e fundit, mbyllja e dy mediave elektronike dhe disa mediave të shtypura e ka zvogëluar dukshëm numrin e mediave që kanë qëndrim kritik ndaj pushtetit. Mbulimi mediatik i fushatës zgjedhore rregullohet me Kodin Zgjedhor, Ligjin për Veprimtari Radiodifuzive dhe Rregulloret e Këshillit për Radiodifuzion. Mediat elektronike janë të obliguara të ofrojnë mbulim të balancuar të fushatës, poashtu ka edhe dispozita që parashohin emitim pa pagesë dhe reklama të paguara.

Ndërkohë që mediat e mbikëqyrura nga MVZ i OSBE/ODIHR-it siguruan mbulim të gjerë të fushatës zgjedhore në lajmet e tyre, kishte një favorizim të dukshëm të partive në pushtet – në aspekt të sasisë dhe të përmbajtjes së raportimit<sup>19</sup>. Të gjitha mediat e mbikëqyrura elektronike, përveç televizionit *Telma*, rregullisht i mbuluan aktivitetet qeveritare, por nuk arritën të bëjnë dallim ndërmjet aktivitetëve shtetërore dhe fushatës së partive. Televizioni publik, Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM) nuk ofroi mbulim të balancuar të fushatës. Kanali i parë i RTM-së, *RTM-1*, 29% të lajmeve ia kushtoi qeverisë dhe 27% VMRO-DPMNE-së, kryesisht me ton neutral ose pozitiv. LSDM-ja kishte mbulim ekskluzivisht neutral ose negativ prej 24%. *RTM-2*, me program në gjuhët e pakicave, kishte qasje të ngjashme, dhe 27% të mbulimit kryesisht neutral ia kushtoi qeverisë, si dhe 21% BDI-së, ndërsa partitë e tjera të mëdha kishin mbulim kryesisht neutral ndërmjet 8 dhe 12 përqind.

Sa u përket kanaleve private, *Sitel* dhe *Kanal 5* i favorizuan partitë në pushtet dhe kishin qëndrim kryesisht negativ ndaj opozitës, ndërsa *TV Telma*, *Alfa* dhe *Alsat-M*, ofruan mbulim më neutral. *Sitel*, 49% të kohës së lajmeve ia kushtoi VMRO-DPMNE-së, 21% LSDM-së dhe 16% qeverisë. *Kanal 5*, 36% ia kushtoi VMRO-DPMNE-së, 26% LSDM-së dhe 16% qeverisë. *TV Telma*, 25% ia kushtoi VMRO-

---

<sup>18</sup> Sipas raporteve, shumica e përgjithshme që është harxhuar nga ana e VMRO-DPMNE-së është 792,826 euro, krahasuar me LSDM-në që ka shpenzuar gjithsej 222,098 euro. Raportet gjenden në <http://www.dksk.org.mk/>.

<sup>19</sup> MMZ-ja e OSBE/ODIHR-it e mbikëqyri periudhën më të shikuar (prej orës 18:00 deri në orën 24:00) të mbulimit politik në shtatë kanale televizive: televizionet publike *RTM-1* dhe *RTM-2*, si dhe *Sitel*, *Kanal5*, *TV Telma*, *Alfa*, *Alsat-M*; gazetat: *Dnevnik*, *Nova Makedonija*, *Fokus*, *Koha*, *Zhurnal* +.

DPMNE-së, 32% LSDM-së, ndërsa *Alfa*, 34% ia kushtoi VMRO-DPMNE-së dhe 30% LSDM-së. *Alsat-M* më tepër u përqëndrua te partitë politike të shqiptarëve dhe 24% të kohës ia kushtoi BDI-së, 12% PDSH-së, 10% RDK-së, dhe 17% së bashku VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së.

RTM-ja e përmbushi obligimin për të ndarë kohë të lirë për emitim pa pagesë për garuesit e zgjedhjeve lokale<sup>20</sup>. Mirëpo, koha e ndarë për këtë qëllim ishte jashtë periudhës më të shikuar, që e zvogëloi audiencën e mundshme dhe interesin e kandidatëve për ta shfrytëzuar atë. RTM-ja krijoi një program special, *Kronika zgjedhore*, për të ofruar një mbulim më të detajuar të aktiviteteve të fushatës zgjedhore. Mirëpo, edhe ky program u emitua jashtë periudhës më të shikuar dhe më shumë se gjysma e mbulimit të saj në *RTM-1* iu kushtua VMRO-DPMNE-së. Përderisa *RTM-1* nuk organizoi asnjë debat, në *RTM-2* u mbajtën 17 debate ndërmjet partive politike shqiptare, shumica e të cilave e favorizonin BDI-në.

Secili transmetues mund të shesë më së shumti 15 minuta brenda një ore për reklama të paguara politike dhe çdo garues mund të blejë deri në 10 minuta të kësaj kohe. Mbikëqyrja e MVZ të OSBE/ODIHR-it tregoi se përderisa koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja i ka shfrytëzuar në masë të madhe reklamat me pagesë, reklamat nga garuesit e tjerë ishin dukshëm më të pakta.

Këshilli për Radiodifuzion obligohet ta mbikëqyrë respektimin e dispozitave nga ana e mediave elektronike dhe duhet të reagojë në qoftë se konstatohen shkelje. Në bazë të rezultateve nga mbikëqyrja e mediave nga KR, ajo ka parashtruar 24 padi kundërvajtëse ndaj 17 kanaleve televizive dhe kryeredaktorëve të tyre për shkeljen e rregullave për reklamim të paguar politik dhe për emitimin e reklamave të paguara nga buxheti shtetëror. Poashtu, mbikëqyrja nga ana e KR-së e zbuloi mungesën e balancit në mbulimin e lajmeve - në favor të partive në pushtet, në shumicën e mediave elektronike nacionale, si dhe shkelje të rregullave për prezantim të rezultateve të anketave nga *Sitel* dhe *Radio MRT*. Deri në ditën e zgjedhjeve, KR-ja nuk ndërmori asnjë veprim për këto çështje.

### **Parashtesat dhe ankesat**

KSHZ-ja është kompetente për ankesat që kanë të bëjnë me regjistrimin e votuesve, shkeljet e të drejtës së qytetarëve për të votuar në ditën e votimit, dhe sa i përket votimit, numërimit dhe mbledhjes së rezultateve. Ankesat ndaj vendimet e tilla shqyrtohen nga Gjykata Administrative, vendimet e së cilës janë përfundimtare. Edhe pse janë paraparë afate të shkurta për shqyrtimin e parashtesave dhe ankesave sa i përket mbrojtjes së të drejtave të kandidatëve dhe të votuesve, Gjykata Administrative iu përmbajt afateve kohore<sup>21</sup>. Në kundërshtim me rekomandimin e mëparshëm të

---

<sup>20</sup> RTM-ja ndau nga dy minuta për çdo kandidat për kryetar komune dhe një minutë për secilën listë të kandidatëve për këshillin komunal.

<sup>21</sup> Në disa raste ankuesi duhet ta dorëzojë ankesën në afat prej 24 orësh nga pranimi i vendimit të KZK-së dhe Gjykata Administrative duhet të vendosë brenda 24 orëve. Për ankesat që kanë të bëjnë me mbrotjen e të drejtës për të votuar, KSHZ-ja duhet të vendosë brenda katër orëve nga momenti i

OSBE/ODIHR-it, KSHZ-ja mund të vendosë për ndonjë ankesë në ditën e votimit, vetëm nëse janë dorëzuar së paku dy ankesa nga i njëjti vendvotim<sup>22</sup>.

Gjatë periudhës së paraqitjes së kandidatëve, në Gjykatën Administrative janë parashtruar njëmbëdhjetë ankesa, ku kontestohet refuzimi i listave të kandidatëve nga KZK-të. Gjykata ka pranuar 4 ankesa. Me vazhdimin e afatit për paraqitjen e kandidatëve, tre lista kandidatësh të cilat fillimisht u refuzuan nga KZK-të për shkak të dorëzimit me vonesë, u ridorëzuan dhe u pranuan.<sup>23</sup>

KSHZ-ja ka pranuar mbi 400 ankesa lidhur me fillimin e parakohshëm të fushatës, por nuk ka reaguar ndaj tyre deri në ditën e zgjedhjeve. Mungesa e procedurave të qarta për trajtimin e ankesave parazgjedhore nga KSHZ-ja nuk garanton ndreqje efektive, si që parashihet në paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të vitit 1990<sup>24</sup>. Përfaqësuesit e disa partive politike e informuan MVZ të OSBE/ODIHR-it se ata nuk kanë parashtruar ankesa për shkak se nuk kishin besim në procedurat për ankim dhe në gjyqet.

### **Vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë**

Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgim të zgjedhjeve nga vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vendorë, si dhe nga përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve në të gjitha nivelet e administrimit të zgjedhjeve. Grupet vëzhguese qytetare që e kishin shpërndarë numrin më të madh të vëzhguesve ishin MOST, CIVIL, dhe Instituti për Demokraci. Në përputhje me rekomandimin e mëparshëm të OSBE/ODIHR-it, të gjithë vëzhguesit kanë pasur të drejtë të marrin kopje të procesverbalit me rezultatet zgjedhore të KZK-ve dhe të KZ-ve.

### **Dita e zgjedhjeve**

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe paqësore, ndonëse u vërejtën disa parregullësi teknike. Disa parti e shprehën shqetësimin e tyre për numrin e madh të votuesve nga diaspora që u kthyen në ditën e zgjedhjeve për të votuar. Të dhënat preliminare të prezantuara nga KSHZ-ja tregojnë se përqindja e daljes në votime ishte 67 %. KSHZ-ja filloi me shpalljen e rezultateve në natën e zgjedhjeve dhe i vendosi ato në ueb-faqen e saj, sipas komunave dhe vendvotimeve.

Votimi i hershëm u mbajt më 23 mars, për votuesit që nuk votojnë në shtëpi, të burgosurit dhe personat e zhvendosur brenda vendit. Vlerësimi i përgjithshëm nga vëzhguesit e MNVZ-së ishte pozitiv në 55 nga 66 rastet e vëzhguara. Megjithatë, në 13 raste nuk u respektua fshehtësia e votës, ndërsa njohja e procedurave të votimit nga

---

pranimit të ankesës. Gjykata Administrative duhet të vendosë në afat prej 24 orësh nga momenti i pranimit të vendimit të KSHZ-së.

<sup>22</sup> Neni 31(2)35 i Kodit zgjedhor

<sup>23</sup> Lidhja e Forcave të majta të Titos, në komunat e Aerodromit dhe të Karposhit dhe Unioni Social Demokratik në Gjorçe Petrov.

<sup>24</sup> Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh se “çdokush do të ketë mjete efektive për korrigjim ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave fundamentale dhe për ta siguruar integritetin ligjor”.

votuesit u vlerësua negativisht në 26 raste. Vëzhguesit e MNVZ-së vërejtën se disa votues në burgje nuk gjendeshin në listat e votimit. Vëzhguesit vendorë ishin të pranishëm në 30% të vendeve ku u vëzhguara votimi i personave që votojnë në shtëpi dhe të burgosurve.

Vëzhguesit e MNVZ-së e vlerësuan pozitivisht hapjen e vendvotimeve në 99% të rasteve të vëzhguara. Shtatëmbëdhjetë vendvotime të vizituara u hapën me vonesa të shkurta, por kjo nuk i pengoi votuesit që të votojnë.

Vlerësimi i përgjithshëm i procesit të votimit ishte i mirë ose shumë i mirë në 94% të rasteve të vëzhguara. Vëzhguesit e MNVZ-së nuk u penguan në punën e tyre, dhe në 98% të rasteve të vëzhguara ata mund t'i vëzhgonin procedurat në mënyrë të qartë. Megjithatë, parregullësi procedurale u vërejtën në 11% të vendvotimeve të vizituara. Këtu bënin pjesë votimi grupor (15%), respektimi i fshehtësisë së votës (12%), votimi në emër të tjetërkujt (3.5%) mosmbyllja adekuate e kutive të votimit (3%). Në 95 raste të vëzhguara, votuesit u kthyen për shkak se emrat e tyre nuk ishin në listat e votimit të vendvotimeve përkatëse. Puna e KZ-ve dhe njohja e procedurave të votimit nga ana e tyre u vlerësua pozitivisht në 90% të rasteve të vëzhguara.

Më tej, MNVZ-ja vërejti se fshehtësia e votës ka mundur të rrezikohet në 60 vendvotime, që kishin më pak se 10 votues të regjistruar në listat e votimit.

Numërimi i votave u vlerësua pozitivisht në 66 nga 81 numërime të vëzhguara dhe vëzhguesit e MNVZ-së kishin mundësi ta shohin qartë procedurën e numërimit në 97% të rasteve të vëzhguara. Mirëpo, procedura e numërimit ishte e paorganizuar në 24 raste të vëzhguara dhe gabime procedurale u vërejtën në 18 numërime të vëzhguara. Ndonëse transparenca e numërimit të votave u vlerësua pozitivisht në 92% të rasteve të vëzhguara, procesverbalet me rezultatet zgjedhore nuk u shpallën publikisht në 44% të vendvotimeve të vëzhguara, si që parashihet me Kodin Zgjedhor.

Vlerësimi i përgjithshëm i procesit të mbledhjes së rezultateve ishte i mirë ose shumë i mirë në 93% të KZK-ve të vëzhguara dhe në përgjithësi, vëzhguesit kishin mundësi të vëzhgojnë pa kufizime. Në 18 raste të vëzhguara u vërejtën disa mospërputhshmëri në procesverbalet e rezultateve zgjedhore të KZ-ve, të cilat kryesisht u korrigjuan nga KZK-të.

Vëzhguesit vendorë ishin të pranishëm në 72% të vendvotimeve të vëzhguara, gjatë procesit të votimit në 74% të vendvotimeve dhe gjatë procesit të numërimit në 80% të vendvotimeve. Poashtu, përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve ishin të pranishëm në 96% të vendvotimeve të vizituara nga vëzhguesit. Gratë përfaqësonin 46% të kryetarëve të Komisioneve Zgjedhore në vendvotimet e vëzhguara.

***Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.  
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.***

## INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

**Shkup, 25 mars 2013** – Misioni për Vëzhgim të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it u hap në Shkup më 25 shkurt, me 11 ekspertë në kryeqytet dhe 16 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin.

Në ditën e zgjedhjeve, janë shpërndarë rreth 215 vëzhgues afatshkurtër, përfshirë edhe delegacionin 15 anëtarësh nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës. Gjithsej, kishte vëzhgues nga 30 vende anëtare të OSBE-së. Nga gjithsej 2,976 vendvotime, votimi u vëzhgua në 831 prej tyre. Numërimi i votave u vëzhgua në 80 vendvotime. Nga gjithsej 81 KZK, procesi i mbledhjes së rezultateve u vëzhgua në 66 KZK.

Institucionet e përfaqësuara dëshirojnë t'i falënderojnë autoritetet për ftesat për vëzhgimin e zgjedhjeve, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për bashkëpunimin dhe sigurimin e dokumenteve për akreditim, dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe organet e tjera për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. Këto institucione, dëshirojnë ta shprehin falënderimin e tyre edhe ndaj Misionit të OSBE-së në Shkup dhe institucionet tjera ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre.

Për informata plotësuese, ju lutemi kontaktoni:

- Ambasadorin Geert-Hinrich Ahrens, Shef i MVZ i OSBE/ODIHR-it në Shkup, (+389 (0)2 3255 200);
- Z. Thomas Rymer, Zëdhënës i OSBE/ODIHR-it, (+389 72 209 788 ose +48 609 522 266) ose zonjën Tamara Otiashvili, Këshilltare për Zgjedhje në OSBE/ODIHR në Varshavë (+48 22 5200 680);
- Z. Juri Landberg, Shef i Delegacionit të Kongresit (+3725278287) ose zonjën Renate Zikmund, Shefe e Departamentit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, në Strasburg (+33 659 786 455).

**Adresa e MVZ të OSBE/ODIHR-it**

Bul. Ilinden, nr.76, 1000 Shkup

Tel: +389 (0)2 3255 200, Faksi: +389 (0)2 3255 201, E-mail: [office@odihr.org.mk](mailto:office@odihr.org.mk)